



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



DATË/A:	22 PRILL 2020
REFERENCË:	PSH. NR. 208/20
PËR/ZA/TO:	AK- Spitali i Përgjithëshem Gjilan
NGA/OD/FROM:	Blerim Dina- Kryetar i Panelit Shqyrtues- OSHP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM

Operatori ekonomik “Telekomi i Kosovës sh. a” - Prishtinë, si palë e pakënaqur me datën: 25. 03. 2020, ka parashtruar në OSHP ankesën me numër 208/20 kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime të telefonisë mobile” me nr. të prokurimit: 634-20-151-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Klinë, duke pretenduar se AK ka bërë shkelje të nenit 9. 4 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimi të ankeses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 30. 03. 2020 kanë autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Eksperti profesional shqyrtues me datën 06. 04. 2020 kanë dorëzuar raportin e ekspertizës ku ka konstatuar se ankesa e operatorit ekonomik ankues duhet të **aprovohet si e bazuar** ndërsa njoftimi për kontratë i KK Klinë të **anulohet**.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 07. 04. 2020 ka njoftuar palët me raportin e ekspertit shqyrtues profesional.

Autoriteti kontraktues- KK Klinë me datën 07. 04. 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit shqyrtues profesional dhe të njëjtit me datën 07. 04. 2020 përmes parashtrësës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues me datën 07. 04. 2020 ka pranuar nga OSHP raportin e ekspertizës dhe të

njëjtë përmes parashtresës me shkrim me datën 10. 04. 2020 kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së që **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues- KK Klinë aktivitetin e prokurimit “Shërbime të telefonisë mobile” me nr. të prokurimit: 634-20-151-221, duhet ta anuloj aktivitetin e prokurimit dhe nëse edhe më tej ka interes të njëjtin ta ritenderoj konform mendimit të dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik “Telekomi i Kosovës sh. a” - Prishtinë konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.